VENDIM
Nr. 130, datë 11.2.2015

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "TIRANË - ELBASAN"(SHTESA)

(ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 555, datë 29.9.2021)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Tiranë-Elbasan"(shtesa).

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë "tokë bujqësore", "kultura bujqësore", "drufrutorë", "truall" dhe "banesë" me vlerë 45 415 312.62 (dyzet e pesë milionë e katërqind e pesëmbëdhjetë mijë e treqind e dymbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e dy) lekë, nga të cilat:

a) "tokë bujqësore" dhe "truall", me sipërfaqe 64 600 (gjashtëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind) m^2, me vlerë 27 271 572.42 (njëzet e shtatë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e dy pikë dyzet e dy) lekë;

b) "drufrutorë", me vlerë 9 499 456 (nëntë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë;

c) "kultura bujqësore", me vlerë 132 936.2 (njëqind e tridhjetë e dy mijë e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë pikë dy) lekë;

ç) "banesë", me sip. 250 m^2, me vlerë 8 511 348 (tetë milionë e pesëqind e njëmbëdhjetë mijë e treqind e dyzet e tetë) lekë.

3/1. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit "tokë arë", me një vlerë të përgjithshme prej 2 622 165 (dy milionë e gjashtëqind e njëzet e dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për pasuritë "tokë bujqësore", "kultura bujqësore", "drufrutorë", "truall" dhe "banesë", prej 45 415 312.62 (dyzet e pesë milionë e katërqind e pesëmbëdhjetë mijë e treqind e dymbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e dy) lekësh të përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2014, zëri "Shpronësimet", planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

4/1. Vlera e përgjithshme shtesë prej 2 622 165 (dy milionë e gjashtëqind e njëzet e dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekësh të përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5/1. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Shlyerja e pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit, të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmuar ZVRPP", të shlyhen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë shlyerjen e pronarëve, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6, dhe 7, të këtij vendimi.

9. Brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t'u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të shlyerjes, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të

shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË PROJEKTEVE TË HUAJA TË BRENDSHME DHE SHPRONËSIMEVE
SEKTORI TOPOLOGJIK

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR TIRANË - ELBASAN (SHTESAT)
(NDRYSHIMET E PROJEKTIT)

Nr.	PRONARI Emri i pronarit	ZK	Nr. ipasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale	Sip (m^2)	Vlerësimet çmimi (lek/m^2)	Vlera(lekë)	Kultura drufrutore	Kultura bujqësore	Vlera totale (lekë)	Shënime
	Fshati Sauk Z.K.3266											
1	Zenel Begtash Begu	3266	258/15	Arë	4200	2890	2622.165	7578056.85			7578056.85	Konfirmim ZVRPP
	Fshati Mjull-Bathore Z.K.2704											
2	Halil Rama	2704	302/5	Arë	2000	161	2622.165	422168.565			422168.565	Çertifikate pronesie (sip. Shtesë)
	Fshati Lunder Z.K.2704											
3	Hamit Isuf Bernaca	2704	578/5	Arë	5530	263	448	117824	97573		215397	Konfirmim ZVRPP
4	Gezim Xhemal Grori	2704	578/7	Arë	3150	140	448	62720	14500		77220	Konfirmim ZVRPP
5	Ali Xhavit Teqja	2704	582/1	Arë	3000	858	448	384384	94500		478884	Konfirmim ZVRPP
	Fshati Stermas Z.K.3517											
6	Qazim Reshit Bernaca	3517	109	Arë	1085	794	448	355712			355712	Çertifikate pronesie
	Fshati Mullet Z.K.2735											
7	Qemal Nevrus Muka	2735	217/44	Arë	1000	341	448	152768			152768	Konfirmim ZVRPP
8	Rustem Asllan Haxhiu	2735	217/28	Arë	6500	1021	448	457408			457408	Konfirmim ZVRPP
9	Hysni Asllan Haxhiu	2735	217/40	Arë	4000	153	448	68544		4435.2	72979.2	Çertifikate pronesie
10	Hysni Haxhiu	2735	217/41	Arë	3000	1458	448	653184		13851	667035	Çertifikate pronesie
11	Bashkepronaret Gjyla	2735	218/9	Arë	3000	390	448	174720			174720	Çertifikate pronesie
	Fshati Bërzhitë Z.K.1170											
12	Tritan Luan Harizi Altin Arben Kore	1170	126/90	Arë	1845	1090	448	488320			488320	Çertifikate pronesie
	Fshati MushqetaZ.K.2752											
13	Musa Ramazan Velia	2752	3/1,	Arë	3500	2792	297	829224	365885	17700	1212809	Konfirmim ZVRPP
14	Shyqyri Hajdar Velia	2752	3/7,	Arë	1000	1000	297	297000	21260	6300	324560	Konfirmim ZVRPP
15	Ramazan Hysni Velia	2752	3/9,	Arë	3500	101	297	29997	85468		115465	Çertifikate pronesie

16	Zini Selman Rama	2752	3/10,	Arë	5000	2098	297	623106	339790		962896	Konfirmim ZVRPP
17	Kadife Abedin Rama	2752	3/2,	Arë	1500	233	297	69201	34715		103916	Çertifikate pronesie
18	Tefik Selman Rama	2752	3/11,	Arë	6650	3492	297	1037124	399980	21480	1458584	Konfirmim ZVRPP
19	Sulejman Zyber Velia	2752	3/3,	Arë	1600	1600	297	475200	382250	7590	865040	Konfirmim ZVRPP
20	Ismail Zyber Velia	2752	3/4,	Arë	2000	1925	297	571725	34580	19180	625485	Konfirmim ZVRPP
21	Bashkim Ibrahim Velia	2752	3/13,	Arë	1010	1010	297	299970	129912	6340	436222	Konfirmim ZVRPP
22	Defrim Ismail Haka	2752	3/6,	Arë	1500	822	297	244134	56850	3780	304764	Konfirmim ZVRPP
23	Kujtim Ismail Haka	2752	3/12,	Pemtore	1500	1500	297	445500		14250	459750	Çertifikate pronesie
24	Kujtim Ismail Haka	2752	27/18	Pemtore	1500	570	297	169290	12870		182160	Çertifikate pronesie
25	Shaqir Sulejman Velia	2752	27/15	Pemtore	1870	1870	297	555390	228965		784355	Konfirmim ZVRPP
26	Bashkim Ibrahim Velia	2752	27/17	Pemtore	490	490	297	145530	78920		224450	Konfirmim ZVRPP
27	Defrim Ismail Haka	2752	27/16	Pemtore	440	440	297	130680	48680		179360	Konfirmim ZVRPP
28	Sheqere Hasan Velia	2752	27/13	Pemtore	1500	531	297	157707	96610		254317	Çertifikate pronesie
29	Refik Nezir Velia	2752	27/14	Pemtore	2000	2000	297	594000	310190		904190	Konfirmim ZVRPP
30	Ramazan Hysen Velia	2752	27/12	Pemtore	1000	670	297	198990	110940		309930	Konfirmim ZVRPP
31	Shyqyri Hajdar Velia	2752	24	Arë	1000	1000	297	297000	163520		460520	Konfirmim ZVRPP
32	Gani Maliq Karafili	2752	4/2/8,	Arë	5730	2165	297	643005	127840	14250	785095	Konfirmim ZVRPP
33	Sherif Ramazan Velia	2752	4/2/4,	Arë	2600	227	297	67419	39899		107318	Konfirmim ZVRPP
34	Musa Ramazan Velia	2752	4/2/5,	Arë	5000	640	297	190080	70540		260620	Konfirmim ZVRPP
35	Besim Karafili	2752	4/2\12	Arë	5000	2165	297	643005			643005	Konfirmim ZVRPP
36	Maliq Dino Karafili	2752	23	Arë	2430	1465	297	435105	323180		758285	Konfirmim ZVRPP
37	Myftar Selman Velia	2752	21/7	Arë	5050	5050	297	1499850	217050		1716900	Konfirmim ZVRPP
38	Sinan Gjysho Karafili	2752	21/1	Arë	1600	1600	297	475200	354894		830094	Çertifikate pronesie
39	Skender Ali Ajazi	2752	21/4	Arë	1400	1400	297	415800	333340		749140	Konfirmim ZVRPP
40	Fatmir Ibrahim Velia	2752	21/5	Arë	650	600	297	178200	393910		572110	Konfirmim ZVRPP
41	Sheqere Hasan Velia	2752	21/6	Arë	960	251	297	74547	72255		146802	Konfirmim ZVRPP
42	Sali Avdulla Ajazi	2752	21/8	Arë	1400	1177	297	349569	286670		636239	Konfirmim ZVRPP
43	Zegjine Velia	2752	22/2	Arë	650	650	297	193050			193050	Çertifikate pronesie
44	Arben Lika	2752	42/11	Pemtore	1300	378	297	112266	104330		216596	Çertifikate pronesie
45	Mexhit Selman Lika	2752	42/10	Pemtore	1200	1045	297	310365	229220		539585	Çertifikate pronesie
46	Ylli Musa Velia	2752	42/9	Pemtore	1400	1352	297	401544	238206		639750	Çertifikate pronesie
47	Fiqiri Ymer Bafti	2752	45/30	Arë	2050	142	297	42174	33834		76008	Konfirmim ZVRPP
48	Xhelal Ali Muharremi	2752	45/26	Arë	5000	2381	297	707157	646520		1353677	Konfirmim ZVRPP
49	Fiqiri Ymer Bafti	2752	169	Arë					1068300		1068300	Me subvencion
50	Ymer Bafti	2752	46/2	Arë		1300	297	386100	359650		745750	Çertifikate pronesie
51	Fiqiri Ymer Bafti	2752	46/3	Arë	1800	1800	297	534600	629800		1164400	Çertifikate pronesie
52	Hysen Selim Velia	2752	58/1	Arë	1050	610	297	181170	100448	3780	285398	Çertifikate pronesie
53	Zyber Mustafa Tarja	2752	58/4	Ullishte	800	258	297	76626	38080		114706	Çertifikate pronesie
54	Hysen Selim Velia	2752	57/4	Pemtore	380	310	297	92070	129650		221720	Konfirmim ZVRPP
55	Fadil Selim Velia	2752	57/3	Arë	308	213	297	63261	209530		272791	Konfirmim ZVRPP
56	Zyber Mustafa Tarja	2752	57/2/1	**Truall**	300	106	324	34344	55632		89976	Konfirmim ZVRPP
57	Mustafa Tarja	2752	57/1	Pemtore	800	800	297	237600			237600	Proces regjistrimi
58	Sali Tarja	2752	57/5	**Truall**	200	200	324	64800	125030		189830	Çertifikate pronesie
59	Mustafa Tarja	2752	53	Arë	1400	1400	297	415800			415800	Konfirmim ZVRPP
60	Sali Mustafa Tarja	2752	51	Arë	1400	634	297	188298	64348		252646	Konfirmim ZVRPP
61	Riza Ibrahim Tafa	2752	55	Pemtore	500	136	297	40392	45710		86102	Konfirmim ZVRPP
62	Osman Riza Tafa	2752	54/1	Arë	1000	162	297	48114			48114	Konfirmim ZVRPP
63	Riza Tafa	2752	52/1	Pemtore	1000	268	297	79596	38000		117596	Çertifikate pronesie
64	Tahir Riza Tafa	2752	52/2/1	**Truall**	300	12	324	3888	55632		59520	Çertifikate pronesie
	TOTALI					**64600**		**27271572.42**	**9499456**	**132936.2**	**36903964.62**	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONAREVE TË OBJEKTEVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "TIRANË-ELBASAN"
(OBJEKTET) SHTESA

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Nr. izonës kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i objektit	Sipërfaqe ndërtimi	Vlera (lekë)	Shënime
1	Bashkëpronarët Zeneli	2752	34/1/1	Banese 1 kt	130m2	5409523	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Tahir Riza Tafa	2752	52/2/1	Banese 1 kt	120m2	3101825	Certifikatë pronësie
	SHUMA TOTALE					**8,511,348**	

LISTA EMËRORE PËRFUNDIMTARE PËR PASURINË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 130 DATË 11.2.2015, "PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT 'NDËRTIMI I SEGMENTIT TIRANË–ELBASAN"'

(shtuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 555, datë 29.9.2021)

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	ZK	Nr. i pasurisë	Lloj i pasurisë	Sip. totale /m²	Sip. e shpronësuar/ m²	Çmimi në lekë /m²	Vlera totale për shpronësim	Shënime
1	Xhafer Myrteza Xhabrahimi	3266	162/47	Arë	1,000	1,000	2622.165	**2,622,165**	Konfirmuar nga DVASHK-ja.
	Vlera totale				**1,000.0**	**1,000**		**2,622,165**	

Shënime.
1. Për tokën "arë", çmimi i llogaritur është marrë nga vendimi nr. 89, datë 3.2.2016, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".